

## INTERVISTË ME MARJAN DEMA

Prishtinë | Data: 31 janar, 2017

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

- Marjan Dema (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Marjan Dema:** Unë quhem Marjan Dema, jam Rektor i Univerzitetit të Prishtinës, “Hasan Prishtina”. Kam lindë me 27 maj, 1957, në fshatin Stupë, komuna e Klinës, në një familje relativisht të madhe. Familje e cila ka pasë një histori, sa të lavdishme qaq edhe tragjike edhe të dhimshme, sepse shumë herët, nuk e di kohën, por serbet, çetat e ndryshme serbe e kanë vra gjyshin tim, por jo vetëm që e kanë vra gjyshin, ai ka qenë t’u punu ia kanë vra edhe kijet që ka qenë t’u livru. Pastaj ajo edhe tradita që i kem pasë kanë ndiku që axha e baba të edukohen në atë frymë anti asaj, atij regjimi asaj mbretetëriës serbo-kroato-slllovene që ka qenë.

Pastaj axha është inkuadru në këto lëvizjet për çlirim dhe në vitin, gjegjësisht gjatë Luftës [së Dytë Botërore] është hakmarrë për shkak të vrasjes së babait të vet, pastaj ka qenë, ka qenë i angazhum në ato lëvizjet, në ato, në ato organizimet që kanë qenë gjatë pushtimit. Dhe natyrisht pas ‘45-tës burgoset, denohet. Mirëpo, në burg arrinë me depërtu dhe i bashkangjitet Çetës së Nupërlleshit, e cila ishte Çetë që numëronte në atë kohë 150 ushtarë. Rruga deri sa është bashku deri te Çeta e Nupërlleshit ka qenë diku bukur e gjatë, pastaj kanë qenë edhe kriteret shumë t’ashpëra për m’u bashku, por për shkak të historikut, për shkak të familjës është bashku.

Fillimisht ka qëndru nëpër malet e Rugovës, pastaj në ni familje fqinje, por jo edhe shumë fqinje se unë jam nga Lugu i Drinit, Drini i Bardhë e ka nda familjen tonë prej asaj familje, ata e kanë mbajtur mshefun në atë kohë dikun dy javë në çilerin e një nuseje. Pastaj një dhëndër e ka mbajtur në shtallë nën kulmin e vet natën, ndërsa ditën ka qëndru me një, si të them mullar t’sanës i rrethum me tallë, është bashku dhe natyrisht ka luftu deri në vitin 1948 kur ka ra dëshmor në fushëbetëj. Kështu që, kjo na ka ndiku që familja me qenë familje e torturume, familje e persekutume. Dhe jemi rritë në atë frymën që gjithmonë bisedat në familje janë bo kundër atij sistemi sepse vërtetë e kemi pagu shtrejt. Ajo e ka shkakto një ngatërresë pastaj që ka ardhë aty në ndërmjet familjes sime dhe një familje tjetër, e cila ka rezultu me dy vrasje, dy vrasje. Kështu që, du ta them që jom rritë në një familje që kemi qenë në sy për të keq nga ai pushtet.

Fëmijëria ime natyrisht në familje të madhe ka qenë sikur edhe të gjitha familjet, një fëmijëri e vështirë pa kushte. Mirëpo, vështirësitë i ka bërë edhe më të mdhaja një incident i cili nuk më kujtohet kur jam rrëzu, a kam qenë duke luajtur, a duke vapru, nuk më kujtohet se më ka ndodhë dy, tre raste kur ka

ndodhë, por e kam lëndu kukun e majt. Kështu që, ajo pak ma ka lëndu, nuk kam qenë në gjendje të vrapoj, të luaj me shokë, natyrisht që kam çalu. Fëmijët, po ndoshta nganjëherë edhe të mdhajt nga padituria, nga ndoshta kultura më kanë quajt, çopë, tapall e të tjera, që për një fëmijë ka qenë shumë e randë.

Por prapë, fëmirija është vështërsu edhe ma shumë, se n'moshën njëmbëdhjetë vjeçare më ka vdekë baba, kam mbetë me nanën natyrisht në familje të madhe, fëmiju, kam qenë fëmiju, në qofse nuk gaboj, vëllau i gjashtë, fëmiju i dhjetë, nuk kam pasë ndonjë kujdes. Mirëpo, megjithatë e kam pasë një intelegjencë natyrore. Kështu që, kur kam fillu në shkollën fillore m'kujtohet kur babai m'tregoi se, mësuesi im i parë ka kërku një amanet nga babai im, amaneti ka qenë shumë i thjeshtë, "Me dërgu Marianin në shkollë". Që në atë kohë, kemi qenë familje fshtatare me shumë tokë, me shumë bagëti edhe ajo pak më ka kushtu, kam qenë në prag të shkoj në shkollë a mos të shkoj shkollë, t'u qenë familje realitvisht e madhe ishte rendi që nga një për familje me shku në shkollë. Edhe vëllau më i vjetër ishte veç në shkollë, mirëpo me insistimin e një vllaut tjetër kam shku në shkollë. Domethanë, ka qenë shumë rrezik që të mos shkoj as në shkollë.

Pas kryerjes së shkollës fillore me të gjitha pesëshe, jam regjistruar në gjimnazin "Luigj Gurakuqi", në Klinë, në atë kohë ishte hapur gjimnazi matematikor, edhe ai vllau im që ishte ma i vjetër kishte dëgjuar për këtë gjimnaz dhe më tregoi. Pastaj unë u interesova edhe ishte hera e parë që unë dola shkova në Prishtinë, sepse unë, nana ime ka qenë nga Shqipëria nuk kom pasë rast që ta shijoj atë ndenjën e dajve ose të dal sikurse dilshin të tjerët sepse i kishin daj të që shkonin për festa, e unë hera e parë që dola jashtë Klinës. M'duket një herë kam qenë në Pejë, në qoftëse s'gaboj, duhej dikush me rujt veturën se e dërgonim me shitë ku di unë, bostan, specia ksi gjera, molla.

Kemi qenë familje relativisht ekonomikisht mirë, dhe u regjistrova në gjimnaz matematikor, kur u regjistrova aty, ai gjimnaz i mbledhte gjithë nxansat ma të mirë nga krejt Kosova. Edhe natyrisht unë isha ma i miri në Klinë edhe në shkollën time fillore, mirëpo kur erdha ishte një konkurrencë shumë e madhe, semestrin e parë mezi kalova mirë, semestrin e dytë kam kalu me të gjitha pesëshe. Kështu që kam qenë rasti ma i veçantë që bëra një progres shumë të madh. Pasi që kam kry gjimnazin matemator, i cili ka qenë gjimnaz shumë i fortë, kemi pasë kuadrin më të mirë të matematikës prej Univerzitetit të Prishtinës, ndodhin problemet.

Në atë verë mendoja ku me u regjistru, në gusht të asaj vere, fqinji i parë m'i vret dy vllazër, njeri ka qenë 26 vjeçar tjetri 43 vjeçar, dy parë jetima, nana ishte e gjallë, pikëllim mërzi edhe tash familja u varfëru, vëllau më i madh që ishte në shkollim ishte në fakultet. Unë duhej ta regjistroja fakultetin, njeri prej nesh duhej me u ndal, edhe ai vllau tha, "Marjan ti vazhdo se je i mirë, e unë do të ndalem". Kjo ka qenë ajo qysh me thonë gjëja që më së shumti në jetë m'ka prekë, dhe unë kam vazhdu në atë kohë. Kur ka ndodh vrasja kam qenë fatkeq që që kam qenë njeri i parë që kam shku edhe kam pa vllaun e madh të vdekun, vllau ma i ri u largu, e thirrsha pa nderpre me gjetë, pastaj kur kam shku pak në dhetë-pesëmbëdhjetë metra i cili ka provu natyrisht me ikë, mirëpo fishektë nuk e kanë leju. Edhe kam ardhë, natyrisht ai vit ka qenë shumë i randë se kam qenë në shtëpi kur i kam dëgju ato pushkë.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na tregu...

**Marjan Dema:** Ato krisma...

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me na tregu rrethanat rreth këtij rasti?

**Marjan Dema:** Po, rrethanat pak kanë qenë lidhen, lidhen edhe me këtë historikun e familjes, se në atë kohë ne ishim në përparim shumë të madh, unë veç duhesha të regjistrohem në fakultet, vllau ishte n'fakultet kisha edhe dy, një djalë të vllaut edhe një djalë të axhës ishin në gjimnaz matematikor.

Domethanë, ishim një familje shumë përparimtare, nuk kam kshtu arsyna, por besoj qe ka qenë dora e pushtetit ta ndale ni rrugë e cila ka qenë ta them den baba den që e kemi shfrytëzu. Tani fqinji e ndali atë rrugë, aty ka fillu ai problemi, çashtjën e asaj rruge deri sa ka kulmu me vrasje të dy vllazërve. Ata kanë qenë duke ngrënë bostan mbrapa gardhit pereshit, ka qenë gushti, te ne është toka pjellore ka gjelbrim edhe nuk kanë pasë, dy metra edhe ju ka marrë jetën të dy vllazërve. Domethanë, kanë qenë thjeshtë arsyna të rrugës, po unë dysjoj që ka pasë dorë të madhe se rruga e cila ka ekzistu den baba den edhe përnjëherë hiqet nga katastri eliminohet. Po sido që t'jetë ajo ndodhi ajo, unë e vazhdova shkollimin, ai vit ka qenë shumë i randë se gjithmonë...

**Erëmirë Krasniqi:** A ishit i kërrcnum edhe ju?

**Marjan Dema:** Urdhno?

**Erëmirë Krasniqi:** A ishit i kërcënum edhe ju edhe pjesa tjetër e familjes apo qysh...

**Marjan Dema:** Po tash do ta tregoj, ajo ka qenë, na kem qenë familje e madhe ata kanë qenë familje ma e vogël, po problemi ka qenë kem pasë dallim në ngritje intelektuale. Na veç fillum me dalë prej asaj familje që kemi qenë me ato, me atë edukatën e vjetër, bamë një kcim. Mirëpo, kjo pastaj, unë vazhdova në shkollim erdha në fakultet në Univerzitet të Prishtinës në Matematikë, kam përfaqsu Kosovën edhe si nxënës i shkollës së mesme në gara edhe në fakultet. Pastaj kam fillu me punu si profesor për shkak tash kishim probleme edhe ekonomike, ajo arsyeja ka qenë edhe ajo rrugë ka qenë burimi, po ka qenë edhe një tokë tjetër ma vonë që lidhet me të, atë toke e kishim ble duheshin borxhe ishim në obligime materiale. Unë fillova me punu si nxënës, si student, posa kreu vitin e dytë në gjimnazin "Sami Frashëri", mirëpo aty fati ka qenë që nuk më kanë pengu, domethanë njëkohësisht edhe punoja edhe vazhdojsha studimet edhe kam kry këtë fakultetin në afat rekord në qershor. Kam pasë notën mesatare ma të lartën në krejt Univerzitetin e Prishtinës, se ka qenë dhjetë vjetori i Univerzitetit të Prishtinës.

Pastaj vjen viti 1983, unë shkoj në specializim, martohna përpara, kam pasë vajzen Valbonën vetëm shtatë ditëshe, kam shku në Lituani për ta përgaditur disertacionin e doktoratës dhe kam arritë rezultate shumë shpejtë për një kohë shumë të shkurtë. Profersori im Vitenska Bajla ma dha një problem tha, "Ky problem është i pazgjidhun në botë në matematikë, nuk di se si zgjidhet, por duhet me pasë zgjidhje", e kom zgjidhë shumë shpejtë. Po pastaj kanë fillu problemet tjera '84-tën m'kanë marrë ushtarë edhe pse isha me atë kukun tim me aftësi të kufizuara ishte, edhe këtu një sfidë tepër e madhe sepse unë kisha kufizime të qëndroj në kamë. Mirëpo, më murën ushtarë pa të drejtë edhe më mbajtën gjashtë muaj. Gjatë asaj kohë prapë pata tragjedi të randa, vëllau im...

**Erëmirë Krasniqi:** A kthehemi te vrasja e parë, në cilin vit ka ndodh? Edhe po më intereson çfarë masa keni marrë, në kuptimin që, a i keni çu në gjyq, a i keni marrë masa ligjore ndaj fqinjit ju?

**Marjan Demi:** Po natyrisht kam...

**Erëmirë Krasniqi:** A keni përdor mekanizma ligjor...

**Marjan Dema:** Po, natyrisht, atëherë pushteti, jemi t'u fol në '76-tën, ka qenë natyrisht ai dorasi është dënu fillimisht me vdekje pastaj ia kanë kthy atë denimin 20 vjet dhe e ka vujt natyrisht denimin. Dhe të kthehem aty ku mbeta shkova ushtar edhe ishte vjeshta kur vllau 21 vjeçar, vllau ma i ri, ka qenë t'u punu t'u livru, ku di unë, edhe me ujin e nxehtë të traktorit e lëndon dorën edhe ajo kalon në helmim të gjakut edhe e fiton sepsën. Mirëpo, nana e sheh, e parandinë që djali i saj ma i vogli Antoni është para vdekjes edhe një mënyrë nëse muj me quajt një vetëvrasje të paqëllimshme dhe një muaj para se me vdek vllau vdes prej një sulmit n'zemër. Kështu që unë vi, isha ushtar, vi me vizitu i mërziur nuk shkova fare në varrim t'nanës, nuk mrrina, se e disha se vëllau është në gjendje ma t'vështirë. shkova e vizitova vllaun. U mërziëm sepse ai prapë kishtë humbë peshë se i kishte kalu n'staza shumë të randa sëmundja, shihej që nuk ka shpëtim.

Pastaj në... me 1 janar ka vdekë 1985 vllau 21 vjeçar. Mirëpo, prapë këto tragjeditë nuk përfunduan, djali i dorasit që m'i vrau dy vllazërit vrau vllaun e tretë, profesorin Pashkun, që duhej njeni të ndalemi ose ai ose unë. Dhe përgjithmonë e kam mendu se ai ka marrë fishekët e mij po të isha ndalë, e kisha pasë unë atë fat. Ka qenë rrugës për të shkuar te stacioni i trenit, mbrinë në Klinë, ku në Klinë ka qenë i punësuar si profesor i biologjisë n'gjimnazin "Luigj Gurakuqi" edhe ai fqinji i shkon përmbra edhe e vret. Fati që kur ka vdekë osh' rrokullisë, se ka mujt në [me ra] mes binarëve edhe treni të mos lej asgjë me vorrosë, po aty ka qenë fati në fatkeqsi. Atëherë kanë fillu...

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ishin motivet e kësaj familje...

**Marjan Dema:** Urdhno?

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ishin motivimet e kësaj familje këtë herë?

**Marjan Dema:** Nuk e dijmë, edhe sot e kësaj dite është enigmë për mua edhe çdo kënd. Në qofse ti hakmerresh, në qofse del n'pritë, se institucioni i hakmarrjes ka qenë te na, ka qenë një institucion i vjetër se e ke ditë nese i ki dikujt borxh është dashtë me u rujtë, e jo me dalë mbrapa me i shku profesorit të cilin e prisnin nxanësit. Por kot e kanë pritë nxanësit se s'ka mrrri me shku të nxanësit, kot e kemi pritë edhe na se as na s'kemi mrrri me pa, sepse ai dorasi ka dashtë veç me ja marrë jetën ndoshta ka pasë ndonjë frigë se mos hakmerret vllau, a ku di unë. Nuk muj të përgjigjem, por nuk ka pasë ndonjë arsy, po arsyeja ma e madhe ka qenë se unë edhe familja nuk kemi qenë për hakmarrje, ndoshta ajo më bren më së shumti, njëkohësisht më mbanë edhe krenar që s'kam leju me u hakmarrë, dhepse pasi ma kanë vra vllaun pastaj m'u kanë kërcnu edhe mu me më vra.

E kërkesa ime ka qenë që i kam thanë vllazërve që, "Kam vetëm një kërkesë, që në qofse më vrasin

mua nuk dua trupi im m'u vorrosë pa e falë gjakun tim. Çfarë bëni me gjaqë tjera..." se veç ishin të vramë tre vllazër. Po ajo që muj me ditë që thjeshtë nuk kanë ditë çka janë t'u bo, thjeshtë noshta ka qenë mënyra që e kanë zgjedhë me mbijetu apo nuk e di ndoshta ata mujnë më thonë ata, unë nuk mund të përgjigjem. Por e di një gjo që jonë vra tre vetë, kanë mbetë tri parë jetima, tri gra ve, mos flas sa loti, sa dhimbja, sa pikëllimi sa zija.

Domethanë, realisht na kemi jetu po nuk kemi pasë jetë, sepse çdo përvjetor sa ka qenë nana gjallë i vajtonte teshat e vëllezërve. Pastaj e ki parasysh kur i ke... po tash me qenë edhe tragjedia ma e madhe kunata ishte shtatëzanë edhe lindi djali, të gjithë u gëzum, thamë lindi vllau prapë, mirëpo pas një muaji edhe ai nuk pat far vdiq. Kështu që për më pak se një vjet kanë qenë tri, katër, katër tragjedi, të cilat thjeshtë... edhepse unë i pata rezultatet nga Lituania nuk kom pasë kohë, as s'kom pasë mendim që me u ulë, idea nuk më ka shku ulë me i qitë në letër që me kry disertacion, se përndryshe kom mujtë me doktorru shumë i ri në moshën 26-27, por prapë pastaj jom qetësu edhe '87-tën kam doktorru, kam mbrojtë temën e disertacionit.

Këto kriza që i kom pasë të rana që vertetë në veçanti, vrasja e vëllaut profesorit, i cili u ndal njeri prej nesh duhej të ndalej, kam pasë krizat aty që ndoshta kam vendosë m'u hakmarrë kam dal prej lëkures time. Një moment më kujtohet shumë mirë profesori im e vrejti, Halil Turku, edhe më thirri në zyrën e tij, po më thotë, në gjitha mënyrat... se si duket e ka vrejte se vrehet njeri, edhe më tha me këto fjalë, "Marjan në qoftëse mujm m'i ngjallë vëllezërit e tu, po vi edhe unë e hakmerrëm bashkë". Domethanë, ai ishte momenti që mi hapi sytë që çkado që të bëjë, vëllezërit e mi nuk kanë me u ngjallë. E pastaj kam vazhdu atë qëndrimin që kam pasë përpara që duhet me gjetë një zgjidhje e m'u ndalë vrasja. Mirëpo, në atë kohë ka qenë e paimagjinushme me mendu për pajtimet.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë naj këshill tjetër, a kanë...

**Marjan Dema:** Po kanë ardhë tash njerëzit, momentin kur mbeta pothuajse udhëheqës i familjes, pastaj ju kam dhanë besë tanë kohën nuk i kam lanë pa besë se kam qenë i vetëdijshëm se nuk e dijnë çka bojnë. Edhe një moment më kujtohet kur kanë ardhë një grup pleqësh për me kërkë besë, edhe unë ju thashë, "Po çfarë bese doni prej meje kur m'u ka kërcnu me më vra? Nuk më mbetët nerë edhe me ju dhanë besë, i bie se unë jam t'u u frigu". Më kujtohet ata më thanë, "Këto janë veprime që ndoshta... " njëri prej tyre ka qenë prift edhe e tha ktë tha, "Kta veç krishti e ka ba", edhe ju kam dhanë besë. E kam pasë në mendje [këtë] më kujtohet që kam shku një herë te një plak në Deçan me shpreh çka o t'u ndodhë, isha për zgjidhje për ato. Më kujtohet shumë mirë kur ka thonë ai plaku, "Ndëgjo po të garantoj se me të ndihmu Zoti edhe ka me përfundu mirë".

Pastaj erdh kjo Lëvizja e Pajtimet të Gjaqeve e Anton Çettës, natyrisht se unë isha veç i përgaditur, natyrisht që kisha autoritet në familje edhe kemi gjetë forcë, edhepse kam qenë i bindun, kam qenë për ata [m'u pajtu], mirëpo akti si akt është shumë i randë. Edhe e kam thanë disa herë po e thom edhe tash, për mua ka qenë me shpreh fjalën qofshin falë gjaqet e tre vëllezërve ëshë thjeshtë sikur me përbi bjeshkën apo diçka ku di unë. Osht' vështirë noshta për ju me kuptu, po për ata që e përjeton apo që është pjesë e atij procesi është shumë, shumë e randë. Mirëpo, megjithatë jam shumë i lumtur që kam arritë me ba një gjest të tillë sepse pastaj janë falë edhe shumë gjaqe tjera sepse ne ishim familje e madhe qysh e përshkrova edhe më parë.

**Erëmirë Krasniqi:** A kanë qenë fqinjët të njejtit konfesion?

**Marjan Dema:** Po, të njejtit konfesion... fqinjë të parë kem qenë, vetëm të parët tanë i kanë prurë ata aty. Mirëpo, ndodhin qysh ndodhin, nuk e di, të njejtit konfesion... konfesion, bile nuk kemi pasë ndonjë, farefisni kështu mirëpo lidhje kështu farifisnore kumarie jo diçka ma tepër. Pastaj kjo më ka ndihmu m'u liru, [jam dhanë] pas pajtimit jam angazhu mjaft edhe në pajtime të tjera, me këto ekipet e pajtimit kam shku...

**Erëmirë Krasniqi:** Kur ka qenë kontakti juaj i parë me pajtimtarët e Anton Çettës, a kishit mujt pak ma detajisht me na përshkrujt qysh ju kanë qasë ata juve?

**Marjan Dema:** Po shiqo, fillimisht kanë ardhë dy intelektualë, kanë bisedu me mua, pastaj kanë ardhë edhe kleri fetar i kishës së vendit, kishës së Llakuqanit, kanë qenë Imzot Mark Sopi, kanë punu. Po nuk ka qenë rezultat i tyre që më kanë bindë mu, une e kam pas atë bindje noshta edhe që është rezultat i vrasjeve që unë s'kam leju me u hakmarrë, unë kam qenë kundër hakmarrjes me atë bindjen që edhe sot e kësaj dite po të isha nuk pendona, se nuk kam dashtë me humb ma shumë njerëz se unë kam konsideru që ata në atë kohë nuk dijnë çka bajnë edhe nëse ti hakmerrësh, po e merr një jetë të njeriut të pafajshëm edhe në të njejtën anë ti po e hup një jetë të një vllaut i cili duhet me shku 15-20 vjet burg.

Kështu që ata kanë bashkëpunu me mua, por nuk ka qenë rezultat i aktivitetit të tyre. Pse nuk kanë pasë... te ne kanë ardhë një herë në familje edhe pastaj kur është kry pajtimi, gjë që në raste tjera na kem shku dy-tri herë, dhjeta herë nëpër familje për me përgaditë. Kjo nuk ka qenë te na, ma shumë ka qenë problem për mu që me i bindë kunatat, familjet e tyre, me i bindë vëllezërit, me i bindë, fati ka qenë edhe aty kom pasë një respekt, edhe aty nuk ka qenë shumë problem se tash t'u qenë pothuajse ndoshta si udhëheqës i familjes kam kontribu për të gjithë edhe aty pata fitu kredi prej të gjithve edhe ajo atëherë më ndihmoi. Unë ato kredi i kom fitu pa ditë që një ditë do të përballëm që me kërkim me ndihmu për me i falë gjaqet, domethanë nuk kam ditë, nuk kam ditë që do të vijë ajo ditë. Nuk e ka ditë askush mirëpo e di që ai plaku i Deçanit më ka thanë me këto fjalë, "Ka me të ndihmu Zoti", po as ai se ka ditë qysh do të zhvillohen, që vijnë ato situata, që populli homogjenizohet, që kthen ti prej, po mendoj një greminë edhe ti e bënë një vepër e cila ka me ndihmu m'u falë e shpëtu sa e sa jetra.

Më kujtohet kur shkonim nëpër familje për pajtim, familje të cilat ishin të asaj ane, me këto fjalë na pritshin, "Meqenëse familja e Marjan Demës ka falë tri gjaqe nuk kam çka me fol". Ishte vështirë edhe për ta se edhe ai kish humb djalin, kish humb vllaun, ishin raste më të lehta. Por rasti ynë ka qenë rasti ma i vështirë ma i ranë në krejt Kosovën, noshta ka pasë raste që ka ndodh edhe katër vrasje, por jo me ndodh në kontiunitet po ndonjë provokim paraprak që m'u nxitë. Njeriu në afekt është në ngjendje me bo krime edhe në përmasa ma të mdhaja, mirëpo këto kanë ndodh të planifikume. Pastaj ne kemi qenë familje e madhe nuk është që, mandej familja, na që... axha ka luftu kundër pushtetit, pastaj kem pasë edhe një vrasje domethanë nuk kem qenë, na kemi qenë familje që nuk kemi ditë me u frigu në atë kuptimin e familjeve të asaj kohe.

Domethanë, kjo ka qenë, kjo ka bo ma madhështore këtë faljen e gjaqeve tona që kanë ndihmu që të

falen edhe, edhe shumë gjaqe të tjera. Pas faljes së gjaqeve natyrisht ka ndryshu jeta ime, ni, ni guri i randë të cilin e kam mbajtë si peshë i cili më ka pengu që gëzimin të mos ta konsideroj gëzim, dasmën të mos ta konsideroj dasëm festën të mos ta konsideroj festë ose ndonjë sukses që e kam pasë qoftë diplomimi në fakultet, magjistraturës, doktoranturës, të mos i ndij shumë mos t'i përjetoj të kanë qenë sikur një pjesë e ditës, një orë e asaj dite. Nuk kanë pasë ndonje domethanie ma shumë. Unë s'kam pasë ndonjë ide që të bëhem asistent, të bëhem profesor ato kanë lindë në mënyrë shumë natyrale sepse nuk kam pasë dikend në familje që ka mujt me ma trasu rrugën ose me më tregu se ku do të shkoj, natyrisht kjo ka rrjedh në mënyrë shumë natyrale. Fillimisht e thashë që mësuesi ka kërku një amanet prej babës me shku unë në shkollë, pastaj unë veç kam msu kam ardhë në gjimnazin matematikor. Natyrisht se edhe aty kam msu, kam pasë mundësi kështu që prapë kam doktoru në moshën 29 vjeçare, në moshë shumë të re përkundër këtyre shumë tragjedive.

## Pjesa e Dytë

**Marjan Dema:** Ajo ka qenë rethana historike, momenti historik, ajo vështirë... nuk ka qenë tepër... mos t'them fillimisht deri sa kanë thy akullin ka qenë aktiviteti, angazhimi i rinisë e i intelgjencës edhe po megjithatë momenti historik i ka pru ato rrethana nuk.... Unë mendoj se përkundër angazhimit që rinia e ka rolin shumë... vet si pjesa ma e bukur e popullit, intelgjencia që ka ndihmu, kleri fetar, mediat në atë kohë, të gjitha kanë qenë unike, çdo gja ka, ka frymu, ka mendu, ka folë për pajtimin. Edhe ato rrethana, ai moment, momentum kisha me e qujtë, vështirë munet me u me u përsëritë. Mirëpo, sa i përket pytyës... përgjigjës në pytyen tande pas pajtimit t'gjaqeve i cili është realizu në kishën e fshatit në Zllakuqan, ku ka qenë një pjesëmarrje shumë e madhe. Pastaj ekipet e pajtimit më kanë ftu që t'marrë pjesë. Ma tepër kam shërby si simbol, ndoshta shumë më shumë kam ndihmu kur s'kam folë fare, vetëm që e kanë përmend rastin tim... e kam fjalën kur kemi shku në, në jashtë rrafshit të Dukagjinit se aty në Lug të Drinit n'ato pjesë ku njif... familjet m'njifshin edhe natyrisht ka qenë e vështirë për mu kur ndëgjojsha që kish raste me falë djalin i cili nuk e dinte kush ia ka vra ose vllaun, që s'dinte, ia kanë falë, ia kanë falë dorasit të panjoftun edhe përdorej kjo, "Kur Marjani ka falë tri gjaqe, unë nuk kom gojë me ju kthy".

Domethanë, kjo ka qenë diçka që njikohësisht m'ka ba mu ndi mirë, mirëpo m'ka ba njikohësisht edhe mu ndi keq se ai ka falë pra. Për ata ka qenë rasti ma i rani, se çdo problem për personin o problemi ma i madhi. Mirëpo, megjithatë n'raport me peshën e randë që e ka pasë falja e gjaqeve të tre vllazërve n'raport me një falje, ajo e ka pasë atë efektin e vet. Kshtu që, unë nuk jam ndalë t'marrë pjesë. Pastaj gjatë tërë kohës që jam mundu me dhanë kontribut, edhe ma vonë kemi shku, ka qenë hera e parë kur në një emison të Rudina Xhungës kur unë e kam përjetu thjeshtë e kam tregu qysh ka ndodhë, dhe ideja jeme ka qenë që unë i njejt njeri kam mujtë me qenë i vrarë, kam mujtë me qenë vrasës, por kam zgjedhë rrugën ma t'mirën edhe për familjen time edhe për familjen e dorasit, që mi falë tri gjaqe, mi shpëtu tri jetë, po jo veç tri jetë, tash n'kuadër t'saj natyrishit që jonë falë, ka pasë efektin e vet, edhe shumë edhe shumë jetra tjera.

Kështu që, unë n'jetë kam pasë shumë rezultate, shumë suksese, por ajo që më bënë m'u ndi [i suksesshmë], n'qoftëse bëjë një rangim, konsideroj është falja e gjaqeve. Se ka qenë diçka që vështirë



osht' me luftu me ndjenja, vështirë o me luftu me institucionin e hakmarrjes, i cili ka pasë rrënjë të thella në popullin tonë. O vshtirë kur e dëgjon ti vajin e fëmive, vajin e nanës, vajin e tërë familjes që mirret jeta jo prej vdekjes normale, jo prej ndonjë aksidenti, por merret pikërisht prej dorës së fqinjit t'parë. Jonë do momente, kjo rrugë që është shumë e vështirë me e tregu e mos t'flas me përjetu ose me qenë, kam qenë pjesë e gjallë e gjithë këtij, e gjithë këtij procesi.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni qenë te Verrat e Llukës? Te Verrat e Llukës a keni qenë?

**Marjan Dema:** Po, kam qenë. Kam qenë...

**Erëmirë Krasniqi:** Si ka qenë atëherë që mundeni me na jep detale?

**Marjan Dema:** Shiqo ka qenë hera e parë në jetën time që kam pa një masë aq t'madhe, një masë që ka qenë e rrethume me forca policore, një masë që nuk osht' frigu askush, një masë që e ka vazhdu ceremoninë, kemi pasë të gjithë atë, atë vullnetin, atë, atë entuziazmin që do t'i eliminojmë hakmarrjen, vlla-vrasjen në popullin shqiptar. Aty ndoshta askush s'e ka mendu vdekjen, të gjithë kemi qenë noshta në një gjendje, mos ta them, jo normale. Kur nuk mendon për vdekjen, nuk mendon, po mendon vetëm kush po falë gjakun. Dilshin njerëz prej mase, vinin njerëz papritë, raste t'pa përgatidura që në t'vërtetë dhanë një mesazh. Aty veç ka fillu edhe pushteti i atëhershëm m'u frigu se ky popull nuk ka t'ndalë.

Edhe unë jam thellë i bindun që falja e gjaqeve nuk e ka vendin të cilin i takon, sepse për herë t'parë populli u homogjenizu, për herë t'parë u bo ni adresë, për herë të parë një popull ka frymu me një, me një shpirt, me një mendje, me një ide, që jo vetëm t'falen... falja e gjaqeve thashë pak ma përpara, ka qenë ai momentum që situata e ka pru, ndoshta krejt ajo ka qenë e frymzume, e fuqizume se të gjithë e donim lirinë, të gjithë ishim të stërlodhur, stërmërzitur me me atë okupimin klasik, me ato torturat të cilat pushteti i atëhershëm i bante ndaj shqiptarve me burgosje, me vrasje t'rive tanë që shkonin ushtarë, madnej shpërguljet prej dhunës, prej persekutimeve e tjera, e tjera. Domethanë, kanë qenë momente t'rana që me një mënyrë i patën ngritë ndjenjat tona se në atë tubim të ndihemi njerëz ma t'lumtun.

Ndoshta me më... po të m'kish pytë dikush, a ke qenë ndonjëherë a ke pasë ndonjë moment ma t'lumtun n'jetën tane? Unë kisha me thanë, jo. Sepse t'gjithë ishim n'qoftese guxoj me e përkthi të dehur me ni... me ni knaqësi që populli ynë po i jep fund vlla-vrasjes, populli ynë nuk donë me derdhë gjak për gjëra t'kota, sikurse unë i kam hupë tre vllazër. Ai ka qenë thjeshtë, ndoshta nuk e di, nuk e di me spjegu mirëpo arritëm që me bo atë, arritëm që me qenë së bashku, me qenë hoxha, me qenë prifti, me qenë shehu, me qenë ku di une, i vjetri, i riu, fshtari, intelektual, të gjihe ishim bashkë, t'gjithë kem pasë veç një dëshirë, veç një qëllim, që mos me mbetë as një gjak i pa falun në Kosovë. Edhe natyrisht rezultatet kanë qenë kulminante që ndoshta osht' vështirë, vështirë një rezultat i tillë të përsëritet.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kujtohet, a ju kujtohet sa gjaqe u patën pajtu?

**Marjan Dema:** Po tash kjo kalu një kohë sa janë, 25 vjet, e di që gjaqet dhe ngatërresat diku 1200 raste

tash 1200, por jo vetëm 1200 familje. Po ti në qoftë se e llogaritë, ata kanë pasë farefis dhe natyrisht n'qoftë se ke qenë e një pale që ka qenë ose damtume ose e palës tjetër, ti nuk ki mujtë me pasë raporte të mira me farefisin e palës tjetër. Kështu që, n'qoftë se ajo shumëzohet, jo familjet në atë kohë kanë qenë dhjetë anëtarshë mesatarisht, n'qoftë se i shton edhe farefisin, domethanë e ki pasë ndoshta më tepër se ¼, noshta edhe ma shumë 25 përqind t'popullatës në hasmëri.

E merre me mend po mos t'kish ndodhë ai pajtim edhe t'na kishë gjetë lufta në qat' hasmëri, ku kishim ditë na kush konë p'e vret? E kur i ke pasë parasyshë propagandën serbe që përdorte, se shqiptarët jonë t'u e vra njeni-tjetrin për shkak të hakmarrjës. Domethanë, ka qenë diçka që edhe me e pasë planifiku, me ni planifikim strategjik ku me ditë sa, unë jom thellë i bindun ajo ka ndodhë rastësisht se ata t'ri na nuk kemi ditë se n'atë kohë ka qenë më tepër ajo bindja paqësore, nuk ka qenë populli i përgaditur që do t'vij lufta. Kështu që, unë mendoj se Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve osht' ndër kryeveprat e popullit tonë që e ka mundësu çlirimin, e ka lehtësu çlirimin, e ka, ja ka mbyllë edhe propagadën, gojën e pushtuesve tanë, e ka mbyllë edhe çdo rast që kish mujtë me ndodhë t'themi me ndonjë prapavi të hakmarrjës e gjërave tjera.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka ndodhë që najkush nuk ka, nuk e ka falë gjakun n'prezencën e juq që është tregu kokëfortë?

**Marjan Dema:** Kemi, kemi pasë edhe raste të tilla. Kemi pasë raste që zakonisht kanë qenë, nuk kanë qenë raste të vështira, po njerëzit kanë qenë t'vështirë. Unë i kuptoj, kurrë nuk i kam gjyku sepse ka qenë vështirë, vështirë me e ba ni kcim prej një gjendje që ke ardhë nuk ka... je t'u folë brenda natës ndryshimi, njerëzit kanë qenë të papërgaditur, s'ka pasë ndonjë përgaditje. Në atë kohë, ju e dini, çdo gjë ka qenë e kontrollume, edhe prej një gjendje të një institucioni shumë të zhvillum të hakmarrjës n'popullin tonë kalon në një institucion të pajtimit. Tash n'kuadër të tyne ka qenë numër shumë i vogël, shumë i papërfillshëm, por njerëzit që nuk kanë mujtë me kalu këtë trans... këtë transformim prej një gjendje me kalu krejt diametralisht t'kundërtën, dhe une i kuptoj nuk ka qenë lehtë as për ne edhe ata që nuk...

Por ajo çka na bënë t'gjithëve krenar që kemi qenë pjesë, po mendoj protagonistat, se e kam thanë heroj të asaj kohe ka qenë ai i cili i ka falë djalin, nana e cila e ka falë djalin, baba që e ka falë djalin ose djali që e ka falë babën, ose djali ka falë gjyshin ose ka falë motrën ka pasë edhe raste t'tilla, kanë qenë ma pak. Sepse ai e ka përbi atë atë shkamb e ka nxerrë fjalën që u falë gjaku i vllaut, i axhës, i djalit, i babës, shumë farefis të ngushtë. Mirëpo, mirëpo doli diçka një forcë e tillë që na i lehtësoj me i nxjerrë ato fjalë, doli qai momentum që e krijoj rinia, e krijoj intelegjenca, e krijoj kleri fetar, e krijun mediat. Ku t'arrihet që, për shembull, për një dukuri negative sot të konvergjojmë t'gjithë me një pikë? Që osht' shumë vështirë, atëherë e patëm atë forcë, ishte moment i rrallë që unë besoj që vështirë ka ndodhë ndonjëhere përpara dhe shumë ma vështirë do të ndodhë në të ardhmën.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kujtohen cilat kanë qenë argumentet që u përdorshin nëpër oda kur shkojshit me pajtu?

**Marjan Dema:** Po fillimisht janë përdorur sipas rasteve metodat, jonë shfrytëzu të gjitha metodat kur kanë qenë rastet e vështira, por kryesisht një pjesë e madhe kanë qenë ma tepër mbi bazën e atij

momentumit që ishte kriju, kto raste tjera jonë përdorë metoda të lloj-llojshme...

**Erëmirë Krasniqi:** Çka u thojke për gjakmarrjen si traditë?

**Marjan Dema:** Po zakonisht kur ishim me profesor Antonin, ai ka pasë do fjalë të urta, gjente raste të vështira, raste madhështore ku njerëzit kanë falë, që s'kanë qenë t'shumta se s'ka qenë n'traditën tonë falja. Mirëpo, i gjente ato [raste]. Pastaj ishte shumë me randësi se rinia, intelegjenca nuk kishin të banin shumë me mesin ku ishin, se tash [të] mesit kur kanë qenë, ka qenë vështirë me ndihmu rrethin, për shkak se rethi ka qenë ose n'farëfis, kanë qenë t'involum n'ni mënyrë ose tjetër. Mirëpo, kur shkonte rinia, shkonte intelegjenca, shkonte kleri fetar disi e kishin atë kredinë me kërku me falë gjakun. Edhe zakonisht, po thom pjesën dërrmuse, t'paktën ato raste kur kam shku une nuk kanë qenë t'vështira. Kemi pasë edhe raste t'cilat, për shembull, nuk kanë dashtë me bashkëpunu me ne, nuk kanë ofru as me shprehë çka kem dashtë. Kem pasë raste që edhe 70 vet kem shku, kemi dale, se kem shku ni here ka qenë pritja e mirë, herën tjetër nuk na kanë pritë ose kanë lanë një plak me na pritë e tjera, e tjera....

Raste ksi të lloj-llojshme, por ajo çka ka qenë shumë me rëndësi ka qenë përkushtimi ynë, vendosmëria jonë, se na i kemi kuptu. Kemi kuptu se para nesh e ki ni njeri i cili osht' rritë, osht' frymëzu, osht' pjekë me atë bindjen se duhet m'u hakmarrë: gjak për gjak. Ajo ka qenë një, një traditë që i ka rrënjët shumë të thella dhe ka qenë vështirë ajo m'u kthy. Mirëpo, prapë, prapë rezultati ka qenë kulminant jonë përdorë të gjitha metodat e mundshme të farefisnisë, të familjës, të gjitha mënyrat që me ardhë deri te ai frymëzimi, që me ardhë deri te ajo që vërtetë me kriju ambientin, ambienti ka qenë i krijumë në popull e thashë, mirëpo me kriju qat' ambient n'familje ku u dashtë me nxjerrë atë, atë fjalë. Që unë i kuptoj, nuk është, nuk është lehtë me nxjerrë ose për një moment çdokush le ta imagjino se dikush ja vret vllaun, ja vret djalin, ja vret babën edhe a është e lehtë me nxjerrë fjalën qoftë falë gjaku i vllaut, i babës, i djalit, i gjyshit apo kujdo tjetër? Osht' një akt shumë i ranë, shumë vështirë me nxjerrë atë fjalë, shumë vështirë.

Mirëpo, megjithatë njerëzit kanë qenë ata heroj, unë i quj heroj që e kanë nxjerrë atë fjalë, e kanë kry atë vepër, fatbardhësia osht' që prej atyne pajtimeve nuk ka pasë hakmarrje. Domethanë, pajtimet kanë qenë, kanë qenë pajtime t'pastra, nuk kanë qenë pajtime që t'paguhet gjaku ose t'blehet, apo t'paguhet dikush. Njerëzit kanë udhtu vet me vetura të veta, kemi udhtu n'kamë, kemi mbulu shpenzimet, ka qenë i vetmi aktivitet ku të gjitha shpenzimet i kemi mbulu n'mënyrë individuale sepse na nuk kemi komunikuar me dorasin, zakonisht osht' komunikuar me atë palën e cila ka falë, pala që ka falë ka pasë pikllim, ka pasë dhimbje, ka pasë momente shumë të vështirë. E ki parasyshtë, me lot jonë falë ato gjaqe, me lot i kanë pranuar edhe ata pala tjetër. Domethanë, ka qenë, ka qenë një atmosferë ku ndoshta sa osht' ndi keq që osht' dashtë me falë aq osht' ndi keq edhe ai që e ka marrë faljen. Se nuk osht' lehtë me pasë përpara ni njeri që e ki shiqu si armik, njeri që ta ka vra ma t'afërmin tond edhe ti duhesh me ia shtri dorën, ose edhe ai dorasi, ose familja e dorasit edhe ai osht' ndi keq sepse edhe për ata nuk ka qenë e lehtë kur e sheh palën e damtume që përkundër që ka humbë ma t'afërmin, ka lot në sy, me lot në sy e me lot n'zemër e nxjerrë atë fjalë që vështirë osht' me e nxjerrë.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ka qenë jeta e juj mandej mas pajtimeve, mas krejt lëvizjes?

**Marjan Dema:** Po kualitet i jetës time ka ndryshu mas faljes të gjaqeve, vijnë kto vitet, fundi i vitetve '90, fillon lufta. Gjatë luftës unë dhe familja ime kemi qenë shume fatkeq, kemi qenë fatbardhë se askush nuk jemi vra, nuk kemi vdekë, mirëpo ka qenë rasti që i kam ndrru dhetë shtëpi, t'u ardhë forcat paramilitare, policore, ushtarake, na kanë largu. Kështu që, ka qenë, ka qenë një, një, një mujsh shumë i vshtirë, me katër fmi, deri sa në Banullë ma kanë djegë edhe veturën. Pastaj kam arritë qysh na kanë largu me mbrri deri në kufi, aty i kam pasë dy rreziqe shumë të mdhaja, të cilat nuk ja fali vetës, por në atë moment i kam bo; një, kam shku deri n'kufi edhe me ni kerr me djalin e vllaut, ai u ndal me kalu, nuk na lanë me kalu edhe nuk dashta me pritë me kalu, me lshu vendin e me pritë, nuk kam dashtë. E kam marrë veturën, e di që kanë qajhtë fmitë, s'di qysh kam marrë vendim. Jam nisë n'ora shtatë nga kufiri këndeje ka Tetova, kam mbrri në ora nantë në Prishtinë, kam pa gjatë rrugës tenka, kam pa vdekjen me sy, por fati ka dashtë edhe kam shpëtu, pastaj....

**Erëmirë Krasniqi:** A jetojshit në Prishtinë në atë kohë a qysh?

**Marjan Dema:** Shtëpia ime e... aty s'kam jetu një lagje ku ka pasë serb, më patën shpërthy një autobombë edhe m'u thynë dritaret, m'u thynë xhamat, u demtu shtëpia, ishte e pa, e pashfrytëzushme. Pastaj kam shku në Prishtinë te një, veç s'e njifsha, farefis i largët, domethanë miku, miku i djalit t'motrës, prej aty pastaj na kanë njëkë, kom shku në Banullë, kam shku në Gadime, jam kthy prapë në Banullë. Pastaj ishte ajo koha kur ne bënim marrëveshje, jam kthy në Prishtinë, pastaj edhe ktu në Prishtinë kam ndrru shtëpia. Dhe pastaj e kam taku grunë e profesor Anton Çettës, edhe m'u lutë tha, "Në qoftë se vendosë m'u largu nga Kosova, të lutem" tha, "merrëm se i kam dy vajza edhe po frigohna që m'i keqpërdorin forcat policore ushtarake." E kam dhanë fjalën që qoftë se vendosi....Dhe tash, t'u i pasë gjithë kto, mos të tham përjetime t'idhta gjatë luftës, fmitë fillun thjeshtë mos me u ndi mirë prej, e ki parasyshë, djali ma i vogli ka qenë katër vjeçar, prej atyne t'shtënave një moment kam qenë për pak t'u u djegë në shtëpi në Banullë, edhe kjo osht' shumë interestant.

Ishte e shtunja e pashkëve, ishim një famlije t'nji haxhiut, ata kishin, s'di as vet, me na befasu kishin përgaditë me na i festu pashkët. Isha unë dhe djali i vllaut në atë familje edhe kur kanë ardhë forcat policore, kanë rrethu fshatin, "O jonë t'u i kërkuj refugjatë", "Mirë!" Na, unë edhe djali i vllaut hypëm në katin e dytë që mos me na gjetë, nuk e di kush ka ardhë, ka bërtitë, na ka thirrë, tjetër t'u ikë se kishin fillu m'u djegë shtëpia. Domethanë, kanë qenë në pyetje sekondat që me mbetë n'atë shtëpi, dhe pastaj kemi ikë deri në... prej Banulle në Gadime, n'kamë kemi ikë, një rrugë shumë e gjatë. Pastaj atje kam shku te një familje që ka pasë pesë fëmi, dy dhoma, ma lshoi ni dhomë, familje e varfun, as nuk kishin banjo, por e kishin një mikpritje, një zemër t'madhe, na i lshun ni dhomë. Tash kjo familja ku mbetën [e mëparshmj], humbën fami... atë shtëpinë e vet e krejt, por u kujdesëm se krijumë njëfarë miqësie edhe ma gjetën një shtëpi tjetër.

Tash u ktheva prapë në... po ishte ai, ai, ai momenti shumë me rëndsi që kur u kthym tash me pa shtëpinë ishin aty qysh kanë fillu m'i pjekë ata drekën, ambëlsinat, atë mishin, kishin gjetë edhe raki edhe pse ishte shtëpi e haxhisë, që unë i kam n'zemër atë familje. Mirëpo, nuk arritëm me festu sepse... po arritëm me mbijetu, nuk kanë dashtë me na vra, se unë kur qitshin ata [me armë] unë i kam pasë, s'i kam pasë as dhetë metra, me pasë dashtë kanë mujtë po nuk.... Si duhet s'ka qenë interesi i tyre me na vra po na largu, e jo murrën...(kollitet) aty, aty ma kanë djegë edhe veturën si

meta pa veturë...

Edhe pastaj kam vendosë me shku edhe ja dhashë fjalën... po kthena te bashkshortja e profesor Anton Çettës, tash e kisha një veturë, që u ktheva, një veturë t'keqe se vetura ime ishte djegë, me atë veturë, xhamin e ka pasë t'thymë, t'u shku me fëmi vendosa me shku në Fushë Kosovë, ende qarkullonte treni me shku në Teto... në Maqedoni. Edhe kam kalu, nuk m'kanë ndalë, kam kalu, i kam lanë shoqen me katër fëmi te rrethi që t'mrrinë. Dhe unë u ktheva me marrë Gjysten me dy vajzat, që e planifikova deri sa t'kthehna une ata shkojnë në kamë, edhe kanë shku n'kamë shoqja me katër fmitë, prej rrethit deri te stacioni i trenit. E pastaj më kanë ndalë, atëherë më kanë ndalë, më kanë mbështetë për muri, nuk e di kanë ardhë disa informata ka, çka ka qenë t'u ardhë ndoni kontrollë a veç m'kanë thonë me këto fjalë, "Hyp n'kerr mos u ndalë askun". Se m'vretjen që isha për herë të dytë edhe aty, edhe aty kam pa vdekjen me sy po rrezikova desha t'i ndihmoj familjës së profesor Antonit.

E pastaj kam shku në Maqedoni, atje kom qenë profesor, veç isha t'u majtë msim në Univerzitet të Tetovës. Kom vazhdu aty, na kanë pritë ni familje, ma kanë gjetë një shtëpi, kam pasë kushtet e mira aty, një shtëpi me oborr. Një koleg, një profesor ma dha shtëpinë e vllaut t'vet. Pastaj ka qenë një program për me i... amerikan me i marrë 20.000 refugjatë nga Kosova, edhe natyrisht unë kam qenë njëra ndër ato familje. Kam shku në Armerikë, atje jam vendosë mirë, kam... ni vjet kam marrë pushim pa pagesë, vitin tjetër jam kthy.

Tash kur jam kthy ktu, prapë lindën disa probleme, ishte ni, ni, ni lëvizje me i largu disa profesor penzioner. Unë mbajsha këtë landën e matematikës, së bashku me një proesor, me Fuat Rizvanollin, ai mbet pa orë, unë i kisha familjen [në Amerikë] se u ktheva veç vet në kuptimin që pastaj me marrë edhe familjen. Edhe u idhnunë menaxhmenti i asaj kohe, shumë u idhnunë, "Na i prishe planin", s'disha çfarë plani e prisha, dojshin m'i largu thashë, "Dëgjo, unë veç e bana për shkak se profesorin s'po du me lanë". Edhe tash kjo lidhet me 2001-tën kur u ktheva, i morra biletat një kahshe, me tërë familjen mos m'u kthy ma kurrë në Amerikë.

Edhe nuk m'lanë qaj i njejt grup, nuk m'dhanë landë u... u mërzita, u mërzita, çka vendosa? Morra prapë biletat një kahëshe mos m'u kthy mo kurrë n'Kosovë. Fëmitë nuk dojshin m'u kthy, se ishin kthy, ishin taku me shokë me shoqe atje, edhepse i kishim t'gjitha kushtet, por megjithatë ende s'e dishin gjuhën, ende nuk arritën me u integru n'rrethin ku jetonim. Edhe u kthym pastaj, kur u ktheva me qëllim që mos m'u kthy më kurrë në Kosovë. Natyrisht, atëherë u integrova në shoqinë aty, ka qenë një komunitet i madh shqiptarë, e bleva një biznes, e bleva shtëpinë, më dhanë para hua, të gjithë m'i dhanë. Kur t'i çon Zoti domethanë, pa limit, mbi bazën e emrit e ato, dhe unë e morra fillova, u stabilizova ekonomikisht, fillova me punu, i angazhum në një univerzitet Amerikan...

**Erëmirë Krasniqi:** Ku ishit i vendosur?

**Marjan Dema:** Kam qenë në Michigan, në Michigan... e pastaj ishte problemi i rektorit ktu në Prishtinë, qeveria se pranonte rektorin, ishin zgjedhjet edhe disa kolegë t'mi, kishin bo një grup, "Hajde, eja me kandidu për rektor", thashë "Eh, rektor, une që katër vjet nuk jam [në Kosovë]", ishte viti 2004, thashë "Jo." T'u bisedu, kishin vdekë shumë profesorë të matematikës, "Kemi nevojë..." "Ah," thashë, "profesor kthehna, veç du me pasë normën e plotë," thashë, "se për shkak t'normës unë jam kthy." "Jo, nuk ka problem." Edhe une vendosa tash, me më pytë dikush arsyeja, i lashë fëmitë, e lashë

grunë, u ktheva në Kosovë. Mendja ime që u stabilizumë, e kisha biznesin, fëmijtë, veç i volgi ishte 12 vjeçar, kta tjerët ishin mbi 17, se katër fmi i kam.

U ktheva, kur u ktheva ishin ato pengesat e qeverisë t'asaj kohe, dhe unë u ktheva pa kontratë, pa asgjë. Ni vjet kam punu, po premtova që do t'kthehem, ni vjet kam punu mirëpo fati kishte univerzitete private, m'anagazhunë ato univerzitete private edhe unë fillova me, me kalu mirë pa, pa probleme materiale, e rregullova shtëpinë. Pastaj ni vit qëndrova, kam qëndu veç vet, pastaj kam marrë shoqën me djalin e vogël. Djali ka qëndru ni vjet, kur kem... kur jemi kthy se tash ndërkohë une kam marrë nënshtetësinë amerikane. Atje isha i integrum dhe kemi themelu, themelum një shoqatë të intelektualëve shqiptaro-amerikan në Michigan që ka qenë një shoqate me një kryesi shumë kualitative, unë kam qenë kryetar i saj, krynim aktivitete t'ndyshme, ofrimin e shkollimit n'gjuhën shqipe edhe shumë aktivitete tjera.

## Pjesa e Tretë

**Marjan Dema:** [...] motivi pse u ktheva?

**Erëmirë Krasniqi:** Ku e gjetët..?

**Marjan Dema:** Kisha dhuratë shumë të randë, tre vllazën t'vramë. Dhuratë shumë t'randë që u dashtë mu kthy prej Fakultetit, Fakultetit Ekonomik. Mirëpo, megjithatë ka qenë diçka e brendshme që as sot nuk di me spjegu. Bleva shtëpinë, pagova borxhet, i pagova t'gjitha, kisha biznesin tem, biznesi ishte shumë, jepsha mësim me një Univerzitet Amerikan. Domethanë, e kisha një jetë që ndoshta veç kam mujt me imagjinu. Jetë përralore. Edhe u ktheva pa fëmi, u ktheva pa punë, u ktheva pa... shtëpinë veç e kisha meremetu, u ktheva n'shtëpi. Po nuk e di, u ngopa. Nuk kam dijtë me i shiju ato t'mira që i kam pasë në Amerikë. Çdo herë m'shkonte mendja te rinia, te Kosova. Nganjëherë mendojsha po mirë, unë n'kohën ma t'vshtirë kam ndejtë atje, tash Kosovën kanë me e ndërto, kanë me zhvillu, kanë tana këto... po kur u ktheva u dëshprova sepse ni vjet qëndrova veç [profesor] i angazhum, domethanë nuk kisha punë t'rregullt.

Pas ni viti u stabilizu Univerziteti, pastaj u pranova. Jam pranu prej fillimit. U pranova në thirrjen e njejtë që kam pasë edhe ma vonë u zgjodha prorektor i Univerzitetit të Prishtinës. Kur isha t'u punu në univerzitete private, krijojsha t'ardhuna shumë t'mira. Më ofroi rektori që të angazhohem prorektor, thashë, "Unë jam kthy prej Amerikës me kontribu", edhe u angazhova, i lashë puntë që kisha edhe kontribova në Univerzitet të Prishtinës si prorektor. Fillimisht për marëdhanje me jashtë, pastaj i mora financat, se financat ishin n'gjendje shumë të vështirë. Ish-rektori më luti që ta marrë atë pjesë se vërtetë ishin jo n'gjendje t'mirë financat e Univerzitetit të Prishtinës. Kam punu natë e ditë. E atëherë, aty jam bind sa ni pjesë jemi shumë ziliqarë edhe më pat' shku n'mendje, sa ka qenë luftë me shliru Kosovën prej dhunës t'huj, tash është me e shliru prej disa njerzve që nuk po munden mej me menaxhu ndjenjat e tyne, s'munden, s'po din me u ngop, aty e vrejta.

Pastaj kam hy pak edhe e kam kërku pak edhe politikën. Ishte Partia Demokristiane Shqiptare n'gjendje kome. M'luten shumë intelektual edhe mendova thash n'atë kohë, ishte viti 2009, mesi i 2009, Kosova kish nevojë për ndërkombtarizim, për njohje. Edhe mendova që do t'jetë ni, ni, ni dritare e mirë Partia Shqiptare Demokristiane, se thashë që përmes marëdhajeve me partitë që janë simotra, të cilat janë shumë t'forta në Evropë. E mora atë detyrë, fitova bindshëm edhe pse s'kam qenë anëtar i partisë fitova dikun 76 deri 80 përqind t'votave n'kuvend. E po politika m'doli krejt ndryshe.

Nuk pata shumë fat politik që me bo ndoni reform. Ideja ishte me ndrru këtë funksionimin e partisë, se filloi si parti që t'lokalizohet veç te elementi kristian, që nuk është, qysh me thanë, bazamenti i kësaj partie, nuk është... janë vlera demokristiane por ajo nuk ka t'bah me parti fetare. Po, nuk e di si ka ardhë ajo, nuk arrita me bo për shkak se menjëherë shpërthyn ato, ajo fryma e zgjedhjeve t'reja. Unë dikun kah fundi i majit e kam marrë detyrën, n'fillim t'tetorit, n'qofse s'gabo, pat' dhanë dorëheqje prej presidenti... menihere veç fillun me... nuk arrita me, me bo ndoni reform, me pru frymë t're. E stabilizova pak, por jo. E pastaj fillun zgjedhjet.

**Erëmirë Krasniqi:** Në cilin vit?

**Marjan Dema:** N'zgjedhje nuk u ndava mirë sepse në atë kohe jonë keqpërdor votat me t'madhe. I fitova dikun 4000 mijë vota, e ato shkojshin t'u m'hup t'u m'i zvogëlu, sepse nuk kishte askush me m'i mbrojt, m'i rujt (të gjithë qeshin). Po sido që t'jetë...

**Erëmirë Krasniqi:** Ka qenë viti 2005 apo 2007?

**Marjan Dema:** Jo, jo, 2010, jo. Pastaj, pastaj unë isha në koalicion me Partinë Demokratike. Ai koalicion nuk u pranua mirë se Partia Shqiptare Demokristiane ishte mësu ma tepër me LDK-në, nuk u pranua mirë. Po unë arsyeja pse hyna ishte se e disha që ka me fitu PDK-ja edhe medojsha në atë kohë se për me dhanë kontribut mundesh n'qoftëse je n'pushtet. Nën hije nuk ka dhe mendoj qëllimi i çdo partije duhet me qenë pushteti në qoftëse është n'politikë. Edhe prej asaj na kishim koalicion me naj, n'qoftëse fitojmë me PDK-në me naj dhanë një ministri dy zavendsministra, mirëpo ku di unë si ka ndodhë na ofrun vetëm ni zavendsministër. Unë nuk pranova. Ata nuk kishte ndoni, nuk ishte koalicion i sinqertë edhe une isha i dëshprum edhe me elektorat timin edhe me (qesh) koalicionin edhe u tërhoqa. Dhashë dorëheqje edhe mendoj që momenti ma i mirë që kam ba n'jetë kur kam dhanë dorëheqje prej partisë edhe pastaj jam angazhu në jetën me komunitetin, jetën sociale.

Kam qenë poashtu anëtar i klubit rotarian, ku kemi, kam qenë edhe kryetar, kemi, japim shumë kontribut edhe sot po tash jam tepër i zanun... shumë projekte n'instalimin e ujit, n'dhanjen e bursave, në, shumë projekte kemi kry, ku është një organizim që paguhet anëtarësi, po askush nuk paguhet. Mirëpo, është një vullnet një ndjenjë shumë e madhe që e kanë rotarianët që m'i ndihmu komunitetit, me ndihmu atë pjesë që nuk jonë fatlum me pasë gjendjen që e kemi ne. Kjo ka ndodh deri në 2015. Univerziteti ishte në gjendje shumë t'vështirë. Unë Univerzitetin e kam n'zemër, jam i lidhun sikur pjesa dërmuse e Kosovës me këtë Univerzitet. Është një ndërtesë e vogël, por është e shejtë, është e madhe për mu dhe për pjesën dërmuse të Kosovës sepse çdo gjë ka qenë e lidhur, e

nxitur, e ushqyme prej këtij Univerziteti. Ishin problem të mëdha.

Fillun procesi i zgjedhjeve të parakohshme, të gjithëmbarshme në Univerzitet, e disa prej kolegve nga Këshilli Drejt... nuk ka qenë ende Këshilli Drejtues në atë kohë m'duket, po ishin profesorë që ishin me emra, me peshë, edhe më lutën t'u e dijtë që unë s'jam interesum për rektor edhe m'lutën me i udhëheq zgjedhjet e parakohshme në UP. Pritova se ishte me t'vërtetë gjendje shumë e vështirë. Mirëpo, kur mendova thashë, "Okej, t'boj diçka t'mirë për Univerzitetin", edhe e mora [përsipër]. S'isha i interesum fare për rektor, zakonisht kur je [nuk ndodh], m'zgjodhën kryetar të KQZ-së, të Këshillit Qendror Zgjedhor të UP-së edhe unë e bona. E mora këtë çka i kishim rregulloret i mora i lexova. E bamë strategjinë, e bamë gjithshka, e parashikum, u takova me atë ekipin që ishin Këshilli, Komisioni Qendror Zgjedhor edhe ju thashë, "Këto janë rregullat, këto janë normat, qikjo oshtë orari, agjenda. Nuk ka lëvizje asni milimetër prej agjendës, nuk ka lëvizje asni milimetër prej rregulloreve, nuk ka lëvizje as të mendojmë për keqpërdorime. T'i ofrojmë diçka t'bukur këtij Univerziteti që asht t'u lëngu pa kurfarë arsye".

Edhe fatbardhësisht, kisha shumë fat, çdo gja shkoj mirë. Bilem i pata thanë disa herë, "Po ndodh një mrekulli". Univerziteti ishte në gjendje shumë t'mjerë, po në anën tjetër u kry një process pa asnjë vërejtje. Kem pasë do ankesa të studentëve pasi kur u kry në do koalicionet tash kërkoshin, se koalicioni ishte shumë i afërt, po ishin ma tepër ankesa se dojshin me ndryshu koalicionin. Mirëpo, aty ndihmoi shumë vendosshmëria ime se nuk lashë m'u hap këto kutijat, i thirra gjithë sekretarët që kanë qenë udhëheqës të këtyre njësive zgjedhore, "A ka pasë ndonji manipulim?" "Jo, i kanë nënshkru gjithë, i kanë pranë gjithë". Nuk lejova. Aty ka qenë madhështija se nuk lejum m'u hap këto kutija, por natyrisht une tash i mbrojta zgjedhjet, i mbrojta rezultatit sepse... nuk i kam mbrojtë individë. Ma panë për t'madhe, por mbrojta procesin. Edhe nuk kanë pasë, kanë pasë kamera me dhjetra, në disa raste, në disa fakultete ku interesoheshin mos... por njerëzit tash gjithmonë, "Nuk oshtë dashtë ky me fitu". Ajo tash nuk oshtë, votuesi është autonom, ai është njeriu që e përcakton. Edhe natyrisht me 4 mars e kishim zgjedhjen e rektorit. Dështun. Ishin dy kandidat n'finale, katër me katër nuk fitoi asnjëni. Edhe tash duhej me u shpall konkursi për rektor. Unë e krevë procesin. Atëherë më ka fillu mem kaplu një ndjenjë t'rrezikoj...

**Erëmirë Krasniqi:** Me kandidu?

**Marjan Dema:** Me kandidu edhe e kom pasë një luftë t'madhe me vetvetën, kisha arsuna, e du Univerzitetin du me ndihmu, kam përvojën. Mirëpo, ishte, ishte (qesh) një gacë, një gacë e ranë me marr n'dorë. Dhe momenti kur kam vendos ka qenë shumë interesant. Këtu n'sheshin Zahir Pajaziti e takoj ni profesor i cili m' respekton po unë e çmoj e du shumë, Feriz Krasniqi, edhe unë isha ende t'u luftu me vetvetën me vendos. Edhe p'e pys, "Profesor si je?" E m'u anku s'e kishte shoqen mirë. Po, natyrisht fjala e parë, se unë isha nëpër media për shkak të procesit zgjedhor, fjala e parë "Hë, çka po ndodh në Univerzitet?" Thashë "Profesor, nuk e di bre Univerziteti e ka lind këtë Kosovë, Univerziteti e ka rritë, Univerziteti ka ba shumë. Tash Univerziteti n'vend që me zhvillu Kosovën duhet, u bo barrë".

Univerziteti ishte në atë kohë, sulmohej prej gjitha anëve, në çdo gazetë në faqe t'para e ki pasë shkrimet prej ma të ndryshme, jo të kandshme për Univerzitetin... dhe ai m'tha me këto fjalë tha, "Marjan," tha, "po më kujtohet ni rast ishim ni tubim" tha, "edhe ni plak mu afru dhe m'pyti 'ku



punon?’ ju përgjegja n’Univerzitet’, ‘e mor biri jem kthehet i thotë plaku, ‘deri tash kur jemi falë jemi kthi kah kibla tash po kthehemi kah Univerziteti’”. Aty e kam vendos, se po rrënoqthem, thashë, “Unë do t’shkoj dej n’fund do t’kandidoj”.

Tash natyrisht e fitova edhe pak atë simpatinë se i mbrojta Univerzitetin, isha ndër t’parët që e mbrojta. S’isha involvum askund, se unë isha tërhjek, unë punojsha n’rotari, thjeshtë me ni mënyrë nuk isha, u tërhoqa se nuk dojsha, thojsha, “Unë isha gjashtë vite, sa kam qenë tri vite anëtar i Këshillit Drejtues, kam dhanë kontribut tri vjet edhe t’ja lëshoj dikujt tjetër”. Fare s’kam mendu me kandidu si rektor. Fitova simpatinë, m’kanë përkrahë studentët, m’ka përkrahë Senati, m’kanë përkrahë Këshilli Drejtus, m’kanë përkrah gjithë. Politika nuk më ka pengu. Kështu qi kam ardhë, kam fillu. Tash natyrisht kom hy gati muji dhjetë, jo mendoj gati muji i dhjetë, me ni... që realisht nesër, sot mbushen plot dhjetë muj.

Univerziteti asht’ t’u stabilizu, është stabilizu. Kem vu standarde, se jam shumë i interesum që përmes standardeve me zhvillu Univerzitetin, sepse Kosova asht’ e vogël, çdokush e njëj çdokënd. Me qenë ato standarde të cilat e lejojnë ose nuk e lejojnë ni individ, po jo bindja e individit, qoftë t’atij rektorit a dekanit a kujdo tjetër. Edhe kemi ba shumë reforma, me të thanë t’drejtën jam shumë i lumtun që kemi arritë një sukses shumë t’madh, se Univerziteti ka qenë n’prag të futjes n’lista t’zeza sepse nuk jemi n’gjendje me udhëheq Univerzitetin, po fatbardhësisht ka kriju klimë shumë konstruktive. Kemi debate, po...

**Erëmirë Krasniqi:** A keni trashëgu probleme t’mdhaja?

**Marjan Dema:** Urdhno?

**Erëmirë Krasniqi:** Prej paraardhësit t’juj a keni trashëgu probleme t’mdhaja?

**Marjan Dema:** Po kemi pasë, ka qenë bllokadë, nuk ka ekzistru komunikim që tri vite. Nuk është marrë Univerziteti me çashtje akademike, thjeshtë tanë kohën e ke pasë Univerzitetin me protesta, tanë kohën me afera me gjana jo të kandshme t’cilat... unë kam provu që edhe stafin me e marrë njerëz që e përfaqësojnë të gjitha fakultetet, domethanë n’qoftëse ka pasë... kam kriju kriteret, qoftëse une jam prej fakultetit të elektros nuk mundet me ardhë prorektori prej fakultetit të elektros, në qoftëse ka pasë [në] Këshill Drejtus fakulteti i drejtësisë nuk mundet me ardh prorektori. Kam përfaqësu edhe gjininë, dy femra, tre mashkuj. Pastaj jam mundu edhe këtë aspektin e gjuhës, s’kam dashtë që prorektorët e mi ose rektori me shku dikun ose me prit delegacione me përkthys, domethanë gjithë e flasin anglishten. Jam mundu edhe atë anën regjionale fshatin edhe qytetin më përfaqësu, kështu që jemi tre me tre, tre jemi nga fshati... i kam për, gjitha i kam, i kam pasë parasysh sepse kam dashtë me qenë ky menaxhment dhe ky Univerzitet i gjithëve.

Edhe elementi fetar, unë jam katolik, që gjithkun e përdori që ni Univerzitet që 97 përqind profesoratit edhe studentëve jonë t’besimit musliman që edhe ajo është respektu. Kështu që, asht’ kriju një ambient shumë i përshtatshëm [që] t’bajmë reforma, ta çojmë Univerzitetin përpara dhe vizioni jonë është që Univerziteti i Prishtinës t’bëhet Univerzitet jo vetëm në rajon po edhe ma larg. E di që kjo rrugë është shumë e vështirë nuk është e lehtë po disi e kam ni besim që do ta realizojmë edhe nuk

dysjoj fare që nuk kemi me realizu sepse kemi vizion ku dojmë me shku, dimë çka duhet, e dimë rrugën si me mbërri atje. Natyrisht që nuk është lehtë sepse profesorët janë t'angazhum, shumë punë, shumë aktivitete.

Por megjithatë mendoj këtë ambientin që kem kriju që çdo gja frymon, çdo gja mendon për t'mirën e Univerzitetit. Është ni ni ni ambijent që ndoshta po t'më kish pyt dikush para dhjetë mujsh nuk kisha me e imagjinu, por e kemi arrit. Sepse nuk ka Univerziteti i Prishtinës, gjegjësisht menaxhmenti nuk ka agjendë individin, kemi veç ni agjendë, Univerzitetin edhe n'kuadër të Univerzitetit studentët. Edhe deri tash jam shumë i knaqun, veçse natyrisht jam shumë i vetëdijshëm se nuk do t'jetë lehtë. Është rrugë e gjatë sepse njerëzit gjithmonë kanë interesa. Prej një gjendje, mos t'tham, të një anarkie akademike ni gjendje të disiplinës, ni gjendje akademike, ni gjendje që çdo gja është e mbulume me rregullore, me norma, me standarde.

Nuk është e lehtë, por kemi arrit pikërisht s'bashku, fillimisht me ekipin tim, pastaj me dekanët t'cilët janë t'u e kry punën e vet, janë shumë t'përkushtum për ndryshime, për reforma, për me ngrit përpara e mbi të gjitha studentët i kanë pranë mirë. Po natyrisht tash n'këtë rrugë kemi shumë detyra për t'kry, avancimin e cilësisë n'mësime, avancimin e shërbimeve t'studentëve, avancimin e lidhjes me tregun. Kemi nënshkru shumë marrëveshje me shumë kompani private dhe publike ku i dërgojmë studentët me bo punën praktike, kemi zhblloku atë, ka qenë e bllokume edhe kjo bashkëpunimi ndërkombëtar, me projekte të ndryshme, pjesa dërmuse e projekteve kanë shku në Univerzitetin e Mitrovicës Veriut, kemi nënshkru shumë marrëveshje me shumë Univerzitete të Evropës, të Amerikës, Turqisë në veçanti...

Domethonë, jemi hapë, kemi shumë fronte që jemi t'u punu edhe ajo mbi të gjitha shka është me randësi, sepse deri tash edhe pse kem trashëgu probleme të cilat natyrisht për shkak të bllokadës janë shkaktuar se nuk ka funksionu Senati, s'ka funksionu Këshilli Drejtus, nuk ka komunikuar rektorati me fakultete. I kemi kry të gjitha ato punë edhe ajo që m'pëlqen është që jemi një Univerzitet i zgjidhjeve edhe deri tash nuk kemi asni problem, asni proces që e kemi adresu, ose që e kemi kry ose është n'proces me u kry, po natyrisht e thashë edhe përpara është rrugë e gjatë. Unë i besoj asaj që do t'i dalim në fund t'asaj rruge. Natyrisht s'nuk kryhet gjithshka, na do ta kryjmë një hap. Po ajo çka është më randësi jemi bind edhe ne, është bind edhe opinioni se Univerziteti i Prishtinës munet me u ndryshu, është duke u ndryshu. Edhe unë mendoj që pa ndryshimin e Univerzitetit të Prishtinës vështirë është me ndryshu Kosova sepse çdo gja ka startu prej këtij Univerziteti edhe ajo që o t'u ndodhë është që edhe tash ka ndryshu, ka fillu ndryshimi Univerzitetit, dhe unë besoj që do t'fillon edhe ndryshimi i shoqërisë në përgjithësi sepse kemi ni rini shumë t'shnosh, ni rini shumë t'bukur, ni rini që është e etshme për dije.

Na në Univerzitet i kemi kushtet relativisht t'mira, prandaj çka na duhet që me ja ofru kësaj rinie një mësim ma cilësor, me i ofru ni t'ardhme ma t'mirë, ni karrierë ma t'mirë, ni vend ku ata kanë me menu për me zhvillu edhe me e avancu, me e dashtë... se fatkqesisht jemi t'vetëdijshëm se pjesa dërmuse e rinisë tonë veç e ka ni synim, me lëshu Kosovën. Ideja e Univerzitetit të Prishtinës është përmes Univerzitetit të Prishtinës me ja bo Kosovën t'ambël, me ja bo Kosovën vend të mundësive, Kosovën që ja ofron realizimin e të gjitha shpresave, dëshirave, andrrave, po natyrisht me anë t'punës. Krejt kjo, krejt kjo mund t'realizohet n'qoftë se e kthejmë atë përkushtimin ndaj punës, e kthejmë këtë

përkushtimin e individit, se individi e ndryshon masën t'u e ndryshu fillimisht nga vetvetja mund t'ndryshohet edhe tansija, e jo sikurse deri tash që t'ndryshohet tjetri, t'ndryshohet qeveria, t'ndryshohet shteti. Shteti, qeverija jemi na, Univerziteti jemi na, populli jemi na, prandaj na duhet m'u ndryshu individualisht n'mënyrë që ta ndryshojmë tansinë.

**Erëmirë Krasniqi:** Mendoj që qetu mundemi me ndal, po në rast që ju doni edhe diçka me shtu, që keni mbetë pa thonë?

**Marjan Dema:** Po, nuk po di, tash nuk e di a kam, se folëm shumë nuk e di a kam... a kam diçka nuk e di... u mundova mi përfshi të gjitha, sigurisht ka ndoni moment që m'ka ik se nuk jonë t'lehta këto edhe m'i tregu po them prapë tash.... Përpara nuk kom mujt m'i thanë kështu, ndoshta koha ka ba t'vetën, përsëritja. Kështu që, jam shumë i lumtun që arrita me i thanë. Ni pjesë t'madhe, nuk po di ndoshta që harrova po s'ka ndoni randësi më, se mbas 47 vitesh kam operu kukun, kam ba ndrrimin e kukut. Tash muj me vrapu, m'u ka përmirësu edhe cilësia e jetës, ndihna ma mirë, jam ma i lumtun, muj me vrapu, nuk m'thotë, "Si je qopë?" "Si je topall?" Domethënë. e kam ndryshu edhe n'atë aspekt. që me ni mënyrë me përkushtim, me entuziazëm, me durim nuk ka qëllim që nuk realizohet. Shtrohet veç çashtja e kohës, nganjëherë ndoshta rezultatet vijnë edhe pa i prit, po jonë, nuk jonë t'rasishme, nuk ka kurgjo t'rasishme n'këtë botë po jonë rezultat i angazhimit, rezultat i angazhimit paraprak edhe natyrisht...

Unë e thashë edhe pak përpara nuk kam mendu që do t'jem rektor i Univerzitetit të Prishtinës, bilem jam tërhjek që kam qenë krejt anash. Kanë provu njerzt me shiqu ky njeri cilin kontribut e ka dhanë gjatë këtyre vlimeve? Unë s'kam dhanë se jom angazhu me dhanë kontribut ndaj komunitetit me punë sociale edhe nuk jam marrë me këto çashtje. Po natyrisht, ai vullneti që e thashë, që m'lindi prej mrenda që me sakrifiku. Se kjo unë e konsideroj, ardhja ime rektor është një sakrificë, se kam ardhë n'momentin kur Univerziteti ka qenë n'pikën ma t'ult t'mundshme, po kemi pasë fat, rruga është e gjatë po deri tash proceset kanë shku shumë mirë, shumë ma mirë se sa që kam mujt edhe me i imagjinu ose me i andrru.

Me pasë, me pasë thanë dikush para dhetë mujsh, "A mundesh me andrru?" e kam dit që do të, do ta arrijmë, se edhe tash jam i bindun, mirëpo për ni kohë kaq t'shkurtë nuk kam prit. Domethonë ka qenë me ni mënyrë befas, po kur t'krijohet ambienti, kur krijohet momentum, kur njerëzit e ndijnë vetën mirë... ideja jeme ka qenë dhe asht' me i bo pjesë t'procesit të gjithë... se po që... jo edhe kur kemi për shembull standarde që i kalojmë, sikur kem pasë platformën për punime shkencore, e kemi çu platformën prej departamenteve n'fakultete, pastaj kemi ardh në Kolegjiun, në Senat, n'mënyrë që, ideja ka qenë që me qenë çdonjeni pjesë e atij procesi. Kur njerzit e ndijnë veten pjesë e procesit e konsiderojnë atë si si produkt t'vetin, si, si, si mos t'tham, ni, ni bukuri t'vetën. Dhe këta e kemi ba.

**Erëmirë Krasniqi:** Shumë faleminderit.

**Marjan Dema:** S'ka gja.